



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"  
SENATI

Nr. 2326 prot.

Shkodër, më 14.07.2022

V E N D I M

Nr. 143 datë 14.07.2022

**"Për financimin e botimeve dhe pjesëmarrjes në Konferenca Shkencore të stafit akademik të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi"."**

Në mbështetje të nenit 3, pika 3, shkronja "c", nenit 38, pika 1, shkronja "k" në Ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë" dhe Statutit të USH-së, me propozim të Rektorit, Senati Akademik në mbledhjen e dates 14.07.2022

**vendosi:**

1. Të shpërmdahet shuma e parashikuar në buxhet te zëri botime dhe pjesëmarrje në konferenca të pedagogëve të USH-së në mënyrë të barabartë mes Njësive kryesore për çdo vit akademik.
  - a) Këtë shumë pedagogët mund ta përdorin për pagesën e *fee-s* (tarifës) së konferencës/botime/ dhe për pagesën e biletave të udhëtimit dhe hotelit.
  - b) Kjo shumë nuk mund të shpenzohet më shumë se në masën 10% (dhjetë përqind) për konferenca ose botime brenda Shqipërisë (vetëm në ato tek lista e revistave që Ministria e Arsimit dhe Sportit të Shqipërisë do të propozojë) ose në rajon (Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi). Shuma tjetër duhet të shpenzohet vetëm për konferenca ose botime në revista të BE-së dhe OECD-së. Përjashtohen nga ky detyrim vetëm pedagogët që kryejnë veprimtarinë e tyre kerkimore-shkencore në fushën e Albanologjisë.
  - c) Njësitë kryesore që nuk e përdorin fondin për vitin kalendarik 2022, në vitin kalendarik 2023 shuma e ofruar të jetë 50% (pesëdhjetë përqind) më pak dhe nëqoftëse kjo nuk përdoret edhe në vitin kalendarik 2024, atëherë në vitin kalendarik 2025 të përjashtohen nga përfitimi i fondit.



- d) Pedagogët duhet të përpiqen të vendosin marrëdhënie bashkëpunimi me kolegë dhe Universitete homologe.
- e) Kriteret e përfitimit të fondit:
- Të jenë pedagogë me kohë të plotë.
  - Të jenë autorë të parë.
  - Të kenë informuar të paktën 2 (dy) muaj para organizimit të konferencës (ose edhe më shpejt me qëllim pagesën e *fee*-s dhe biletave me vlerë sa më të ulët).
  - Të jenë të pranishëm në konferenca (nuk lejohet pjesëmarrja apo prezantimi në distancë.).
  - Të paraqesin brenda 2 (dy) javëve pas ardhjes së tyre një relacion të shkurtër mbi pjesëmarrjen e tyre në aktivitetin e zhvilluar.
  - Të deklarojnë (si 'Mirënjohje') në botim ose tek prezantimi që financimi i tyre kryhet nga Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi".
  - Pedagogë që janë punësuar në vitin akademik 2021-2022 (do të marrin 50% të shumës vitin e parë).
  - Të mos jenë duke përfituar leje akademike.
  - Të mos jenë pedagogë që vazhdojnë studimet e doktoratës jashtë shtetit dhe nuk janë të angazhuar me kohë të plotë në USH.
  - Të kenë gradën "Doktor i Shkencave" ose të jenë duke vazhduar studimet e doktoratës.
- f) Të tjera
- Nëqoftëse një pedagog nuk dëshiron të shpenzojë fondin për vitin kalendarik 2022, por dëshiron ta shpenzojë atë për vitin kalendarik 2023 (psh. në një konferencë me *fee* të lartë etj.) i jepet e drejta ta bëjë këtë vetëm nëqoftëse vë në dijeni, jo më vonë se data 30 tetor, Rektorin, si dhe Drejtorinë e Financës dhe Realizimit të Buxhetit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Zv/rektori, Administratori, Drejtoria e Financës dhe Realizimit të Buxhetit
  3. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit.
  4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. *Skizana* GOLEMI

